

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2017
- Statusi Ligjor: Shoqatë jo fitim prurëse
- Selia Qendrore: Rr. "Nikolla Tupe", Nd.4. Ap.2, Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: www.buildgreenalbania.org
- Email kryesor i organizatës: contact@buildgreenalbania.org,
- Telefoni kryesor i organizatës: +355692235144,

2. Misioni

Qëllimi i organizatës është të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet kërkimit shkencor dhe zbatimit të projekteve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, duke bashkëpunuar me entitete publike dhe private, në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, me fokus mjedis dhe novacion.

3. Fushat Kryesore të Fokusit

Fushat kryesore të fokusit të organizatës përfshijnë kërkim shkencor, qëndrueshmëri dhe novacion të cilat shtrihen në disa veprimtari kyçe:

- **Ndërgjegjësim dhe Ngritje Kapacitetesh:** Ofrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për aktorë të ndryshëm (QH).
- **Kërkim dhe Studim Shencor:** Duke filluar nga identifikimi i nevojave, vlerësimi i ndikimit dhe zhvillimi i rekomandimeve dhe planeve të veprimit, përmes përdorimit të qasjeve dhe metodologjive të avancuara dhe analizave të thelluara.
- **Hartim Grantesh dhe Zbatim Projektesh:** Përvojë disa vjeçare në hartimin dhe zbatimin e projekteve që nga faza e shkrimit, aplikimit deri në zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë me parteritete rajonale dhe ndërkombëtare si dhe ofron shërbime për organizatat private e publike.
- **Shërbime Eksperte dhe Konsulencë:** bazuar në nevoja në sektorë të ndryshëm, nëpërmjet një grupi ekspertësh të specializuar.
- **Angazhim Publik dhe Bashkëpunim:** midis komunitetit dhe vendimmarrësve, duke promovuar përpjekje bashkëpunuese me entitete lokale dhe ndërkombëtare.
- **Ngritje Kapacitetesh dhe Edukim:** për qeverisjen vendore dhe qendrore, bizneseve, shoqërisë civile dhe komuniteteve, përmes programeve të rritjes së kapaciteteve.
- **Inovacion dhe Mbështetje:** Organizata mbështet dhe promovon dhe zbaton aktivisht projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që theksojnë inovacionin dhe zhvillimin e në përputhje me objektivat globale të qëndrueshmërisë.

4. Aktivitetet/Programet Kryesore

Roli i organizatës, shtrihet në dy programe kryesore ku përfshihen: (1) *Edukimi mbi Ndryshimet Klimatike* dhe (2) *Dixhitalizim Mjedisor*. Vetëm gjatë viteve të fundit, Build Green Group (BGG) ka përvojë të gjerë në menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë, duke zbatuar mbi 50 projekte nga programe të rëndësishme si *Horizon Europe*, *Erasmus+*, *RECONOMY*, si dhe nga organizata si *GIZ* dhe *UNIDO*. Disa nga projektet më të fundit përfshihen: "*Digital Green Skills for Climate Change Adaptation and Mitigation Strategies*" dhe "*Fast Forward*", duke përfshirë mbi 400 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ngritje kapacitetesh dhe zhvillim aftësish nëpërmjet trajnimit; *VET TO VET* me një total prej 152 mobilitetesh, 92 kurse

trajnuese dhe hartimin e udhërrëfyesve për praktika të gjelbra dhe të qëndrueshme; *WaterWise Hub* (21 partnerë nga BE), një qendër ekselence që lidh dhe mbështet studiuesit, bizneset, industrinë, dhe pushtetin vendor e qëndror; *"IWRIS - Sistemi i Integruar i Qëndrueshmërisë së Ujit"* në kuadër të Rastit Sdudimor 4 të ARSINOE, projekt i Horizon Europe, me fokus përdorimin e një teknologjie novatore nëpërmjet integrit të sensorëve për monitorimin në kohë reale dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore si dhe angazhimin e komunitetit lokal në Liqenin e Prespës dhe Ohrit; *Aligning management objectives with tourism impacts*, me qëllim mbështetjen e qeverisjes lokale për vendimarrje të informuar në menaxhim efikas të zonave të mbrojtura, përmes krijimit të një harte digjitale dhe angazhimit të komunitetit lokal; *Open-source application suite* për (M)NVM-të në Shqipërinë e Veriut, duke kontribuar në tranzicionin e gjelbër dhe digjital të Shqipërisë, mbështetur me asistencë të përshtatur për 25 biznese lokale; *"Resilient Selenicë Initiative – Pathways2Resilience"*, me fokus një angazhim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për qëndrueshmëri ndaj klimës si dhe *"Ideas2Actions4CircularFuture – Circular Economy Week 2025"* me fokus përfshirjen e drejtpërdrejtë të të rinjve në ekonominë qarkore; *Ecosystem Builders – Boosting Support for MSMEs in Albania*, me fokus ngritjen e kapaciteteve të 6 dhomave kryesore të tregtisë dhe mentorim individual për bizneset; *Backstopping Services for the implementation of EU Funded Programs in R&D and Innovation in Albania*, ngritje e kapaciteteve të (QH), duke përfshirë NASRI, PKN-ve dhe aktorëve kombëtar në progamet e financuara nga BE, veçanërisht Horizon Europe. Fokusi i BGG shtrihet gjithashtu në mbështetjen e aktorëve lokal duke përfshirë qeverisjen vendore dhe aktorëve, si dhe ka organizuar qindra nisma e aktivitete mjedisore në nivel lokal, kombëtar, rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe BE.

5. Shtrirja Gjeografike

Build Green Group operon në nivel lokal dhe kombëtar (Tiranë, Durrës, Korçë, Kukës, Dibër, Vlorë, Selenicë, Pogradec, Lezhë, Pukë, etj.) në Ballkanin Perëndimor (Kosovë, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi) si dhe partneritete në vendet e BE-së si Spanjë, Portugali, Itali, Kroaci, Greqi, Rumani, etj.

6. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Françeska Korançe

Bordi i Drejtuesve: Donika Xhafaj; Albina Dhima; Teodora Kita; Besmira Rrika; Ville Korpela

7. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Build Green Group ka bashkëpunuar me donatorë ndërkombëtarë, ndër të cilët: EACEA, European Commission, GIZ, UNIDO, USAID, RECONOMY, EIT, PONT, Rockefeller Brothers Fund.

8. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Build Green Group është organizata zbatuese e ngritjes së Qendrës së Komunitetit EIT në Shqipëri (*EIT Community Hub Albania*), një nga organizatat themeluese të *Green Building Council Albania* si dhe një nga organizatat themeluese e *LogEx Community*.

Build Green Group ka fituar çmimin "Energy Globe National Award 2020", një çmimi botëror për qëndrueshmërinë.